

# Kategorizimi i Strukturave Akomoduese

## Kategorizimi i Strukturave Akomoduese

Në zbatim të Urdhrit nr.267, datë 24.07.2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar procesin e Kategorizimit të Strukturave Akomoduese.

## Afati për Aplikim

Çdo subjekt, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, është i detyruar të aplikojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për t’u pajisur me certifikatën e kategorizimit brenda datës 31.12.2019, për të përfituar shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese.

## Kategoritë për të cilat do të aplikohet:

- a) “Bujtinë” ;
- b) “Fjetinë” (Hostel);
- c) “Kamping”;
- ç) “Hotel”;
- d) “Motel”;
- dh) “Resort”;
- e) “Qendër kurative”;
- ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

## Dokumentacioni i kërkuar (origjinal ose kopje të noterizuara):

- a)Kërkesë sipas modelit, [shtojca 2](#), e rregullores;
- b)Formulari i vetdeklarimit, sipas modelit, [shtojca 3](#), e rregullores;
- c)Akti i pronësisë ose përdorimit të strukturës;
- ç)Vërtetim për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese.
- d)Planimetrinë e strukturës akomoduese;
- dh)Vërtetimin që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
- e)Vërtetimin që struktura plotëson kushtet higjieno sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;
- ë)Foto të brendshme dhe të jashtme të objektit (me ngjyra);
- f)Vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit/administratorit;